



VENDIM

Nr. 129, Datë 31.10.2015

MBI

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLAT PËR CERTIFIKIMIN E
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT
NATYROR**

Bazuar në neni 38 pika 2, të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”; Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuar me Ligjin nr. 9051, datë 03.04.2006, Vendimit të Këshillit Ministerial Nr. D/2011/02/MC-EnC, si dhe në përputhje me Direktivën 2009/73-EC dhe Rregulloren EC Nr. 715/2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës për disa ndryshime në rregullat e certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të gazit natyror,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror. (Bashkëlidhur Rregullat me ndryshimet sipas këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI